

UDHËZIM
Nr.113, datë 4.8.2011

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2001, është 9 300 (nëntëmijë e treqind) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.31, datë 20.1.2001, është 9 800 (nëntëmijë e tetëqind) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2011 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2011, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrojtja Sociale”, tit.10 430, kap.1, art.606

4. Udhëzimi nr.2211, datë 25.11.2010 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2011.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera